



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**Datë:** 06.03.2025  
**Numër Protokolli:** 1524/2025

**A.nr.170/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Ylber Ftehaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.170/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja A.Sh., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2025, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ** i filluar sipas ankesës me numër A.nr.170/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.Sh.

**A r s y e t i m**

Kandidatja për pranim në shërbim civil, A.Sh. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 22.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00015137, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “*Inspektor i Punës*” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt, të shpallur nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Inspektorati i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Inspektorati Qendror i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.170/2025, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024, shpallë Konkursin publik me numër Reference: RN00015137, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën “*Inspektor i Punës*” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt, shtatë (7) vende pune, me afat për aplikim

nga data 14.09.2024 deri më datën 13.10.2024, sipas, shkresave të lëndës rezulton se në këtë procedurë rekrutimi ka aplikuar edhe ankuesi, dhe se i njëjti sipas Njoftimit me numër protokollit 6140/2024 të datës 02.12.2024, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, mirëpo nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk ka marrë pjesë në fazat tjera të vlerësimit.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se pasi që nuk kam marrë përgjigje me kohë në lidhje me mbajtjen e testit me shkrim, rrjedhë se nuk kam qenë i përgatitur për testin me shkrim, dhe për atë nuk kam marrë pjesë në test. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa konkursin me numër Reference RN00015137, për pozitën Inspektor i Arsimit ta anuloj në tersi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati F.R., si kandidatë aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015137, më datë 21.01.2025 kishte parashtruar në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.144/2025, të datës 27.02.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015137, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën “Inspektor i Punës” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.220/2025, të datës 27.01.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.144/2025, të datës 21.01.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015137, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.220/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.170/2025, të datës 22.01.2025.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **Lënda me numër: A.nr.170/2025**

**Ylber Fetahaj**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Procesmbajtëse*

*Kryetare e Kolegji*

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses A.Sh.;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.